

NOA Energy Trade sh.p.k

**Raporti i Audituesit të pavarur dhe
Pasqyrat Financiare të konsoliduara
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	i
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E KONSOLIDUAR E PERFORMANCËS DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIME SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE	5-18

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionerët dhe drejtimin e shoqërisë Noa Energy Trade shpk

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara (më poshtë referuar “Pasqyra Financiare”) të shoqërisë Noa Energy Trade shpk (këtu e më poshtë referuar “Grupi” ose “Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2022, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit me datën 31 dhjetor 2022, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza per Opinion

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara*. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë entitetin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi.

Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.
- marrim evidencat të mjaftueshme të auditimit të duhur në lidhje me informacionin financiar të subjekteve ose aktivitetet e biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe performancën e auditimit të Grupit. Ne mbetemi vetëm përgjegjës për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tirana, Albania
20 qershor 2023

Kledian Kodra
Kodra



Audituese Lijpore
Olsona Fekaj
LF

NOA ENERGY TRADE sh.p.k
Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2022
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shëni me	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021	1 janar 2021
AKTIVE				
Aktive afatgjata				
Investime	11	53,527,462	53,272,450	56,927,614
Aktivitet afatgjata materiale	12	11,328,661	14,099,448	90,507,284
Aktivitet afatgjata jo-materiale	13	96,675,242	127,071,816	22,401,268
Aktive afatgjata totale		161,531,366	194,443,714	169,836,166
Aktive afatshkurtra				
Mjetet monetare dhe ekuivalente me to	7	346,159,781	306,810,232	5,967,152
Të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit	8	1,092,044,640	1,049,559,871	561,713,198
Garanci	9	708,726,000	88,654,800	6,685,000
Të tjera të arkëtueshme	10	558,215,035	383,107,567	243,987,764
Tatimi mbi fitimin	16	25,451,162	-	-
Aktive afatshkurtra totale		2,730,596,618	1,828,132,470	818,353,113
AKTIVE TOTALE		2,892,127,984	2,022,576,184	988,189,279
DETYRIME DHE KAPITALI				
Kapitali				
Kapital i paguar	18	431,293,021	291,293,021	291,293,021
Fitimi i vitit		470,357,572	403,458,441	57,405,442
Totali i kapitalit		901,650,593	694,751,462	348,698,463
Detyrime afatshkurtra				
Të pagueshme	14	1,637,762,519	814,629,799	147,236,580
Hua afatshkurtra	15	-	30,750,526	439,704,407
Detyrim tatim fitimi	16	-	77,045,369	5,804,706
Detyrime të tjera	17	352,714,871	405,399,028	46,745,123
Detyrime afatshkurtra totale		1,990,477,390	1,327,824,722	639,490,816
DETYRIME DHE KAPITALI TOTAL		2,892,127,984	2,022,576,184	988,189,279

Pasqyra e konsoliduar pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-18 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Drejtimi i NOA Energy Trade sh.p.k më 9 qershor 2023 dhe firmosur për llogari të tyre nga:

P. *Nediona Koprencka*


 Gentian Sula
 Administrator

[Signature]

 PricewaterhouseCoopers Consulting Sh.p.k.
 Hartuesi

NOA ENERGY TRADE sh.p.k

Pasqyra e Konsoliduar e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga shitjet	19	14,870,866,362	7,469,261,147
Kosto e mallrave të shitur	20	(14,151,052,789)	(6,582,633,285)
Të ardhura bruto		719,813,574	886,627,862
Furnizime dhe shërbime	21	(44,261,059)	(32,079,314)
Shpenzime të personelit	22	(12,752,827)	(7,576,864)
Shpenzime amortizimi	12/13	(34,244,758)	(7,700,742)
Humbje nga mosarkëtimi i aktiveve financiare	23	-	(252,245,996)
Shpenzime të tjera	24	(26,798,326)	(16,422,818)
Të ardhura të tjera	25	-	1,782,004
Fitimi operativ		601,756,603	572,384,132
Shpenzime financiare	26	(54,399,833)	(50,430,092)
Të ardhura financiare	26	10,698,923	2,809,439
Shpenzime financiare neto		(43,700,910)	(47,620,653)
Fitimi para tatimit		558,055,692	524,763,479
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	27	(87,698,120)	(121,305,038)
Fitimi i vitit neto		470,357,572	403,458,441
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		470,357,572	403,458,441

Pasqyra e konsoliduar e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-18 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

NOA ENERGY TRADE sh.p.k

Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	<u>Kapital i paguar</u>	<u>Fitime të mbartura</u>	<u>Total</u>
Pozicioni financiar më 1 janar 2021			
Rritje kapitali	291,293,021	57,405,441	348,698,462
Dividend i shpërndarë	-	-	-
Fitimi vitit	-	(57,405,441)	(57,405,442)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	<u>291,293,021</u>	<u>403,458,441</u>	<u>403,458,441</u>
Pozicioni financiar më 1 janar 2022			
Dividend i shpërndarë	291,293,021	403,458,441	694,751,462
Rritje kapitali	-	(263,458,441)	(263,458,441)
Fitimi i vitit	140,000,000	(140,000,000)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2022	<u>431,293,021</u>	<u>470,357,572</u>	<u>901,650,593</u>

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-18 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

NOA ENERGY TRADE sh.p.k
 Pasqyra e Konsoliduar e Fluksit të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022
 (shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti operativ		
Fitimi i vitit para tatimit	558,055,692	524,763,479
<i>Rregullimet për:</i>		
Shpenzime amortizimi	12/13 34,244,760	7,700,742
	<u>592,300,452</u>	<u>532,464,221</u>
Rënie/(Rritje) të arkëtueshme tregtare	(42,484,769)	(487,846,674)
Rritje në te arkëtueshme të tjera	(795,178,668)	(221,086,943)
Rritje/ (Rënie) në llogari të pagueshme	823,132,720	667,393,219
Llogari të pagueshme të tjera	(52,684,157)	358,653,905
	<u>525,085,578</u>	<u>849,575,068</u>
Tatim fitim i paguar	(190,194,651)	(50,064,375)
Mjete monetare neto arkëtuar/(përdorur) në aktivitetin operativ	<u>334,890,927</u>	<u>799,510,693</u>
Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(1,077,399)	(35,963,454)
Investime	(255,013)	3,655,164
Mjete monetare neto përdorur në aktivitetin e investimit	<u>(1,332,412)</u>	<u>(32,308,290)</u>
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i financimit		
Overdraft	(30,750,526)	(408,953,882)
Dividend i paguar	(263,458,441)	(57,405,442)
Mjete monetare neto nga aktiviteti i financimit	<u>(294,208,967)</u>	<u>(466,359,324)</u>
Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to	<u>39,349,549</u>	<u>300,843,080</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të periudhës	<u>306,810,232</u>	<u>5,967,152</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor	<u>346,159,781</u>	<u>306,810,232</u>

Pasqyra e konsoliduar e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-18 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

NOA ENERGY TRADE sh.p.k

Shënime Shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria 'NOA Energy Trade' Shpk u themelua në 2 shtator 2014 si Person Juridik me NIPT L42203031A. Pasqyrat e konsoliduara financiare përfshijnë shoqërinë NOA Energy Trade Shpk dhe degën e saj në Kosovë (referuar së bashku në vazhdim si "NOA", ose "Grupi"). Dega në Kosovë është regjistruar në 29.06.2021.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 'Për Shoqëritë Tregtare' dhe nga statuti i saj si edhe Shoqëria aktualisht zotëron licensën për aktivitetin e shitjes së Energjisë, akorduar nga Enti Rregullator i Energjisë.

Veprimtaria kryesore e Shoqërisë është kryerja e aktivitetit të furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike duke shfrytëzuar burimet e energjisë, të cilat gjenden në natyrë dhe janë të rinovueshme. Gjatë vitit 2018 Shoqëria ka përfshirë në objektin e veprimtarisë dhe në statutin e saj tregtimin e çertifikatave të gjelbra dhe të gazit.

Shoqëria ka të punësuar 3 punonjës më 31 dhjetor 2022 (31 dhjetor 2021: 2 punonjës), nga të cilët 1 punonjës i përket Kosovës.

Administratorët e Grupit janë Z. Gentian Sula për Shqipërinë dhe znj. Besiana Antoni për degën e Kosovës.

Adresa e Shoqërisë në Shqipëri është Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2, Tiranë, ndërsa në Kosovë adresa është rruga Rexhep Luci 5, Prishtinë.

2. Bazat e përgatitjes

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit Pasqyrat Financiare në përputhje me legjislacionin Kontabël në Shqipëri. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.1 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike. Bazat e matjes për çdo aktiv, detyrim, të ardhur apo shpenzim shpjegohen me detaje në vazhdim të këtij shënimi shpjegues.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon të përdoren vlerësime të rëndësishme kontabël. Gjithashtu është e nevojshme që drejtimi të përdorë gjykimin e tij në zbatimin e politikave kontabël të shoqërisë. Fushat në të cilat kanë një shkallë të lartë gjykimi dhe kompleksiteti, ose ku supozimet dhe vlerësimet kanë ndikim domethënës në pasqyrat financiare janë të paraqitura në shënimin 4 "Gjykime dhe çmuarje të rëndësishme kontabël".

2.2 Vijimësia

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në mbi parimin e vijmësisë, e cila është supozimi se Shoqëria do të vazhdojë të realizojë fitime në të ardhmen të parashikueshme dhe do të jetë në gjendje të realizojë aktivet e saj dhe të shlyejë detyrimet e saj në veprimtarinë normale. Më 31 dhjetor 2022, Shoqëria gjeneroi një fitim neto në shumën 470 milion lekë (31 dhjetor 2021: 403 milion lekë). Më tej, Shoqëria kishte një pozicion aktive neto në pasqyrën e pozicionit financiar prej 901 milion lekë më 31 dhjetor 2022 (694 milion lekë më 31 dhjetor 2021).

Gjithashtu, të ardhurat nga kontratat me klientët u rritën me 7,401 milion lekë gjatë vitit 2022 (6,474 milion gjatë vitit 2021).

Bazuar në gjykimin e drejtimit, Shoqëria planifikon që aktiviteti i saj operacional të jetë në rritje dhe në vitin në vijim parashikohen rezultate pozitive

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat Financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrorjve gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Degës dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken

(a) Vlerësime dhe gjykime

Informacioni lidhur me vlerësimet dhe gjykimet që janë bërë në aplikimin e politikave kontabël, të cilat kanë edhe efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare paraqitet si më poshtë:

Shënimi 2.2 - gjykimet mbi përdorimin e parimit të vijimësisë

Shënimi 3.10 – njohja e të ardhurave

Politikat kryesore kontabël të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare janë të prezantuara më poshtë. Këto politika janë përdorur në mënyrë konsistente në të gjitha vitet e prezantuara, përveçse kur specifikohet ndryshe.

3. Politikat kryesore kontabël

3.1 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një aktivitet afatgjatë material njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitet afatgjatë material. Amortizimi vjetor i aktiveve është si më poshtë:

Aktive afatgjata materiale	%
Pajisje dhe instalime teknike	20
Aktive të tjera	20
Pajisje informatike	25

Metodat e amortizimit dhe vlerat e mbetura rishikohen në çdo datë raportimi.

Aktivitet afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale përfshijnë koston e licencave dhe software që ka shoqëria. Këto kosto amortizohen mbi jetën e tyre të dobishme.

Aktive afatgjata jomateriale

Licensa	15% me metodën linare
Software	25% mbi vlerën e mbetur

3. Politikat kryesore kontabël (vazhdimi)

3.2 Llogari e kërkesa të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

3.3 Inventarët

Inventarët njihet fillimisht me kosto historike dhe në vijim vlerësohen me vlerën më të vogël mes koston dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes për njësi, i zvogëluar me shpenzimet e ndryshueshme të shitjes. Kostoja e inventarit përfshin koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kur inventarët konsumohen, vlera e tyre e mbetur njihet si shpenzim në periudhën në të cilën e ardhura përkatëse njihet. Shuma e rënies në vlerë të inventarëve deri në vlerën e realizueshme neto si dhe të gjitha humbjet nga inventarët njihen si shpenzime në periudhën në të cilën rënia në vlerë apo humbja ndodh.

3.4 Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar.

3.5 Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën dhe llogaritë rrjedhëse në banka.

3.6 Zhvlerësimi

(i) *Aktivet financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjëndje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale duke qenë se numri i klientëve është i kufizuar dhe shumat në fjalë janë të mëdha. Për ato klientë që kanë detyrime ndaj shoqërisë në datën e raportimit, shoqëria monitoron pagesat pas datës së raportimit dhe para se të lëshohen pasqyrat financiare duke u siguruar që shumat të shlyhen plotësisht. Në rast se ka ende shuma të pa-shlyera pas datës së raportimit dhe para se të miratohen pasqyrat financiare, shoqëria merr parasysh marrëdhënien e vazhduar me klientin, garancitë e mundshme bankare të vendosura nga klientët në favor të saj si dhe mundësinë e shlyerjes përmes kompensimit me ato klientë që janë edhe furnitorë.

Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristikë të ngjashme të rrezikut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e performancës.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e performancës.

(i) *Aktivet jo-financiare*

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.7 Detyrimet financiare

Shoqëria i njeht fillimisht detyrimet financiare në datën e tregtimit, kur bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e tij kontraktuale shlyhen ose anulohen apo përfundojnë. Aktivitet dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëriaka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën

3.Politikat kryesore kontabël (vazhdimi)

neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Detyrimet financiare të Degës janë si vijon: hua dhe llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera. Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të lidhura direkt me transaksionin. Për huatë e marra drejtpërdrejt nga Shoqëria Mëmë, norma e tregut është përcaktuar fillimisht duke iu referuar normave mesatare të ofruara nga banka e nivelit të dytë në Shqipëri. Diferenca midis vlerës së drejtë në momentin e njohjes fillestare dhe vlerës nominale të huasë konsiderohet si kontribut nga aksioneri dhe kontabilizohet si rezervë në kapital.

3.8 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale (Lek) dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e performancës.

3.9 Përfitimet e punonjësve

Pagat, kontributet ndaj shtetit dhe sigurimet, leja e zakonshme dhe jo, shpërblimet, përfitimet jo monetare (si p.sh shërbimet shëndetësore) janë përllogaritur në vitin kur këto shërbime janë kryer ndaj punonjësve të Degës.

3.10 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas masës së realizimit të tyre dhe lidhjes që ato kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, pavarësisht nëse arkëtimi i tyre apo i një pjese prej tyre do të ndodhë në një ushtrim pasardhës. Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që shoqëria do të ketë përfitimet ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitimet mund të maten me besueshmëri.

Për matjen me besueshmëri të rezultatit të një transaksioni që përfshin ofrimin e shërbimeve është konsideruar plotësimi i kushteve të mëposhtme:

- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Ekziston mundësia që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të arkëtohen nga njësi ekonomike;
- Faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës së raportimit mund të matet në mënyrë të besueshme;
- Kostot e ndodhura për transaksionin dhe kostot që priten të ndodhin për përfundimin e transaksionit të mund të maten në mënyrë të besueshme.

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur titulli i pronësisë, rreziqet e lidhura dhe përfitimet janë transferuar nga shitësi te blerësi. Shoqëria në baza mujore bën rakordime me OST-në ku paraqiten të gjitha transaksionet mujore që janë kryer si tranzitim i energjisë elektrike, eksporti i energjisë elektrike, importi i energjisë elektrike dhe shitjet brënda vendit.

3.11 Të ardhura të shtyra

